REPUBLIKA E SHQIPERISË

# UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
## FAKULTETI I ARKITEKTURES DHE URBANISTIKES

Nr. 256/5 prot. Tiranë, më 18.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 65 Datë 18.09.2023**

Dekanati i Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, pasi u njoh me Vendimet e Departamentit të Arkitekturës, Departamentit të Urbanistikës dhe Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar për punësimin e stafit akademik me kohë të pjesshme për secilin departament gjatë vitit akademik 2023-2024,

**V E N D O S I**

Të miratojë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar për punësimin e stafit akademik me kohë të pjesshme për secilin departament gjatë vitit akademik 2023-2024.

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni gjenden:

Vendimi i Departamentit të Arkitekturës
Vendimi i Departamentit të Urbanistikës
Vendimi i Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**D E K A N I**

**Prof. Dr. Armand VOKSHI**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", 54, Tiranë , Tel/Fax: +355 (4) 2229045, www.fau.edu.al info@fau.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Tiranë 13.09.2023

Nr 8

**VENDIM**

Departamenti i Arkitekturës, në mbledhjen e datës 13.09.2023 vendosi:

**Kriteret për pranim të personelit akademik me kohë të pjesshme:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në profilin Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatet preferohen me mesatare mbi 9 në lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë, ose të kenë aktivitet të spikatur profesional në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatet që zotërojnë gradën doktor ose të jenë në proces të mbrojtjes së Doktoraturës në fushën e Arkitekturës (preferohen studentët e shkollës së Doktoraturës në FAU)
3. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi
4. Preferohen kandidatë me eksperiencë në mësimdhënie, në specialitetin apo fusha të ngjashme me disiplinat ku aplikojnë, për të kontribuar si personel akademik me kohë të pjesshme.

**Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatet për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

1. Letër motivimi (specifike për çdo aplikim)
2. Dokument identifikimi
3. C.V. e përgjithshme e përqendruar (*short-bio*, jo më e gjatë se një faqe), *portfolio* e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar)
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë

Rruga "Muhamet Gjollesha", 54, Tiranë Tel/Fax: +355 (4) 2229045 www.fau.edu.al info@fau.edu.al

**Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: drejtuesi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënës i lëndës (apo të lëndëve të ngjashme)

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga konkurrenti (60 %)

- Vlerësimi i konkurrentit përmes një interviste në komisionin e vlerësimit (40 %)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse

**Drejtues i Departamentit të Arkitekturës:**

**Prof. i Asoc. Denada VEIZAJ**

| KURSI | DEGA | Lëndë që mbulohen nga Departamenti i Arkitekturës |
|---|---|---|
| VITI I | A+U+D | Gjeometri Deskriptive 1 |
| | A+U+D | Gjeometri Deskriptive 2 |
| | A+U+D | Vizatim i lirë dhe histori arti |
| | A+U+D | Grafikë arkitektonike |
| | A+U | Bazat e Projektimit Arkitektonik |
| | A | Evolucioni i ambientit të ndërtuar |
| | A | Gjeneza të mendimit bashkëkohor në Arkitekturë |
| VITI II | A+U | Komunikim grafik - CAAD1 |
| | A+U | Kompozicion, Analizë Forme e Hapësire |
| | A+U | Studio Arkitekture 1 |
| | A+U | Komunikim grafik – CAAD2 |
| | A+U | Studio Arkitekture 2 |
| VITI III | A+U | Studio Arkitekture 3 |
| | A+U | Studio Arkitekture 4 |
| VITI IV | A | Komunikim grafik – CAAD 3 |
| | A | Studio Arkitekture 5 |
| | A+U | Projektim Ambiental |
| | A | Studio Arkitekture 6 |
| | A+U | Lëndë me zgjedhje (Kërkim Shkencor dhe Etike Profesionale) |
| VITI V | A | Studio Arkitekture 7 |
| | A | Arkitekturë Interieri |
| | A | Adaptim Arkitektonik |
| | N+H+M+GJ | Gjeometri Deskriptive dhe Vizatim Teknik |
| | N | Grafike Inxhinierike dhe Projektim Arkitektonik |

| KURSI | DEGA | Lende qe mbulohen nga Departamenti i Arkitekturës |
|---|---|---|
| VITI I | D | Bazat e projektimit të Interierit |
| VITI II | D | Workshop 1 |
| | D | CAD+Grafikë 1 |

| | | |
|---|---|---|
| | D | CAD+Grafikë 2 |
| | D | Workshop 2 |
| | D | Histori dhe Teori Dizajni 1 |
| | D | Praktikë Profesionale 1 |
| | D | Histori dhe Teori Dizajni 2 |
| VITI III | D | Workshop 3 |
| | D | CAD+Grafikë 3 |
| | D | Lëndë me zgjedhje |
| | D | Praktikë Profesionale 2 |

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

Tiranë, më 15.09.2023

Nr. **53** Prot.

**VENDIM**

**Nr. 9, Datë 15.09.2023**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË DU, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Bazuar në Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës;
Bazuar në Vendimin e UPT, nr.116, dt. 22.09.2020 "Miratimin e procedurës për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT";
Mbështetur në Udhëzimin e MASR, nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngakesën mësimore të personelit akademik në IAL;

**VENDOSI**

Të miratojë kriteret e punësimit për personel akademik me kohë të pjesshme, si më poshtë:

- Të ketë Diplomë të nivelit Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Arkitekturë, Urbanistikë, ose të afërta me to, sipas specifikës së lëndëve;
- Të ketë notë mesatare të ponderuar për secilin cikël studimi apo të ciklit të integruar, së paku 75/100. Preferohet mesatarja mbi notën 9 për grup-lëndët e disiplinave ku aplikojnë;
- Preferohen kandidatët që kanë fituar gradën shkencore 'Doktor' në Arkitekturë dhe Urbanistikë;
- Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë mësimdhënie në lëndët e specifikuara;
- Preferohet të ketë botuar artikuj shkencorë në fushat që mbulon Departamenti;
- Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati:

1. Letër motivimi/interesi për lëndët ku kandidohet;
2. Jetëshkrimi i detajuar (CV) akademik dhe profesional;
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;

4. Kopje e diplomave universitare dhe listës së notave të noterizuara. Kopje të noterizuar të gradës shkencore me përmbledhje të temës së mbrojtur. Për diplomat dhe titujt e fituar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njohja dhe njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
5. *Portfolio* punësh të lidhura me fushën e arkitekturës dhe urbanistikës;
6. Letër reference nga dy persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti);
7. Dëshmi e gjuhës së huaj.

Vlerësimi i kandidatëve:
Komisioni i vlerësimit të kandidatëve do të bazohet në:
- vlerësimin e dosjes së aplikantit 60%
- vlerësimin e intervistës përpara komisionit 40 %

Në përfundim të vlerësimit, Komisioni harton listën e kandidatëve në rend zbritës e cila do të shërbejë për plotësimin e vendeve vakante për lëndët e shpallura.

**DREJTUESI I DEPARTAMENTIT**
**Dr. Jonila Prifti**

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

Lista e lëndëve me pozicione vakante për staf akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Urbanistikës

| | |
|---|---|
| 1 | Analizë qyteti dhe territori |
| 2 | Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit |
| 3 | Urbanistikë 1 |
| 4 | Projektim i mjedisit të ndërtuar |
| 5 | Histori urbanistike |
| 6 | Planifikim territori |
| 7 | Projektim urbanistik 2 |
| 8 | Legjislacion arkitektonik e urban |
| 9 | Gjeografi urbane |
| 10 | Transport dhe Infrastrukturë |
| 11 | Ekonomi tregu dhe ekonomi urbane |
| 12 | Lëndë me zgjedhje 1:<br>Sociologji urbane<br>Politika urbane dhe territoriale<br>Kërkim shkencor dhe etikë profesionale |
| 13 | Menaxhim urban |
| 14 | Elemente peizazhi |
| 15 | Rigjenerim Urban |
| 16 | Metoda kërkimore të aplikuara në Urbanistikë |
| 17 | Filozofi dhe antropologjia e qytetit |
| 18 | Sisteme Informacioni (G.I.S) |
| 19 | Politikat e strehimit - Housing |
| 20 | Lëndë me zgjedhje 2:<br>Teori Bashkekohore te urbanizimit<br>Qyteti bashkëkohor: ndryshimet dhe politikat sociale<br>Hapësirat publike dhe dizajni urban |
| 21 | Planifikim Urban |
| 22 | Urbanistikë |
| 23 | Njohuri mbi planifikimin dhe projektet urbane |
| 24 | Njohuri Njohuri mbi planifikimin dhe projektet urbane |

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS

Tiranë, më 14/09/2023

**Lënda:** Përcaktimi i kritereve të vlerësimit, të personelit akademik me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, për vitin akademik 2023-2024

**VENDIM Nr. 1**

Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në mbledhjen e datës 14.09.2023, vendosi:

**Kriteret për vlerësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2023-2024, si më poshtë vijon:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatët preferohen, të kenë notë mesatare mbi 9, në grup-lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë.
2. Kandidati duhet të ketë eksperiencë, së paku prej 3(tre) vitesh, në mësimdhënie, ose në profesion, në specialitetin, e grup-lëndëve të disiplinave ku aplikon.
3. Preferohen kandidatët që zotërojnë gradën shkencore doktor, ose që janë të përfshirë në procesin e përgatitjes së tezës së Doktoratës në fushën e Arkitekturës.
4. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr.54, Tiranë, Tel/Fax: +355(4)2229045, web: www.fau.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS

**Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për personel akademik me kohë të pjesshme:**

1. Letër motivimi (specifike për çdo aplikim)
2. Dokument identifikimi
3. C.V. e përgjithshme e përqendruar (*short-bio*, jo më e gjatë se një faqe), *portfolio* e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar)
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë, apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë

**Vlerësimi i kandidatëve për personel akademik me kohë të pjesshme:**

Komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, i ngritur pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, që përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, drejtuesi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënës i lëndës (apo lëndëve të ngjashme), bën vlerësimin e kandidaturave, si më poshtë vijon:

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga kandidati (60 %)

- Vlerësimi i kandidatit, përmes një interviste nga komisioni *ad-hoc* i vlerësimit (40 %)

Në përfundim të procesit, komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse.

**Anëtarët e Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Dr. Entela Daci | Dr. Loreta Çapeli | Dr. Etleva Bushati | Dr. Endrit Tuzi |
| Dr. Marsida Tuxhari | Dr. Jonida Meniku | MSc. Llazar Shyti | Dr. Andronira Burda |

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS

Tiranë, më 14/09/2023

**Lënda:** Përcaktimi i lëndëve, të cilat kërkojnë punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, për vitin akademik 2023-2024 dhe i numrit të personelit akademik me kohë të pjesshme.

## VENDIM Nr. 2

Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, vendosi:

**Të miratojë lëndët, të cilat kërkojnë punësimin e stafit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2023-2024 dhe i numrit të personelit akademik me kohë të pjesshme, si më poshtë vijon:**

a) **Në Programin e Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Arkitekt/Urbanist**

| | |
|---|---|
| 1. Elemente të ndërtesës | 2 pedagogë |
| 2. Teknologji arkitekture 3 | 2 pedagogë |
| 3. Histori arkitekture | 2 pedagogë |
| 4. Teori Arkitekture dhe Urbanistike | 1 pedagog |
| 5. Fizikë teknike | 2 pedagogë |

b) **Në Programin e Studimeve të Ciklit të Parë, Bachelor në Dizajn**

| | |
|---|---|
| 1. Elemente të ndërtesës | 1 pedagog |

c) **Në Programin e Ciklit të Dytë të Studimeve, Master Profesional, në Restaurim Monumentesh Kulture**

1. Mjedisi Arkeologjik dhe ndërhyrjet restauruese — 1 pedagog
2. Historia dhe metoda të analizës së Arkitekturës — 2 pedagogë
3. Metodologjitë e rilevimit dhe prezantimi i monumenteve të kulturës — 2 pedagogë
4. Restaurimi: ruajtja dhe vlerësimi — 2 pedagogë
5. Restaurimi i materialeve dhe sipërfaqeve dekorative të arkitekturës — 3 pedagogë
6. Konsolidimi i ndërtesave historike — 2 pedagogë
7. Rikuperimi dhe rijetëzimi i monumenteve — 1 pedagog
8. Bazat ekonomike dhe menaxhimi i pasurisë kulturore — 1 pedagog
9. Katalogimi dhe muzeografia — 1 pedagog

d) **Në Programin e Studimeve të Ciklit të Parë, Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi**

e) **Në Programin e Studimeve të Ciklit të Parë, Bachelor në Hidroteknikë**

1. Arkitekturë teknike — 3 pedagogë

**Anëtarët e Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Dr. Entela Daci | Dr. Loreta Çapeli | Dr. Etleva Bushati | Dr. Endrit Tuzi |
| Dr. Marsida Tuxhari | Dr. Jonida Meniku | MSc. Llazar Shyti | Dr. Andronira Burda |